

VENDIM
Nr. 21, datë 20.2.2012

**PËR MIRATIMIN E APLIKIMIT TË OST SHA PËR NDRYSHIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012–2014**

Në mbështetje të neneve 9, 24 dhe 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.2.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a., për ndryshimin e planit të investimeve për vitin 2012-2014, nuk ka impakt në tarifën e transmetimit të miratuar për OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 dhe përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e shoqërisë OST sh.a., për ndryshimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani